



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:244919

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05484694

C.nr.1210/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Venhar Salihu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. Sh. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Blerina Dërmaku, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në pagë në bazë të licencimit - kualifikimit, futjes së shkallës së inflacionit dhe i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 4,432.13 €, jashtë seancës, me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. Sh. nga Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër kompensimit të diferencës së pagës mujore – pagesës shtesë të të ardhurave për licencim periudhën 18.11.2019 – 31.01.2023, përkatësisht për 39 muaj, duke llogaritur nga 64.8 € për muaj, t’ia paguaj shumën prej 2,527.2 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 18.11.2022, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që në emër të inflacionit në pagë për periudhën kohore 24.11.2020 – 21.11.2022, duke llogaritur pagën bazë të paditëses, t’ia paguaj shumën prej 774.78 €; dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 22.01.2021 – 21.11.2022, për 116 ditë pune, duke llogaritur nga 2 € në ditë, t’ia paguaj shumën prej 232.00 €; apo shumën e përgjithshme prej 1,006.78 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 24.11.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura në kompensimin e pagës sipas licencimit edhe sa i përket periudhës 01.01.2019 – 18.11.2019 dhe në kompensimin e inflacionit sa i përket periudhës 01.01.2018 - 24.11.2020, në shumën e përgjithshme prej 898.15 €.

IV. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 146.00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, me datë 18.11.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në pagë në bazë të licencimit-kualifikimit.

Më datë 24.11.2023 ka bërë ndryshimin e kërkesëpadiisë duke kërkuar nga e paditura edhe futjen e inflacionit në pagë dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit.

Në padi dhe ndryshim të saj ka theksuar se e njëjta është e punësuar si mësimdhënëse në SHMT "Mehmet Isai" në Gjilan, sipas kontratës së punës në kohë të pacaktuar, ndërsa asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura si punëdhënëse sipas përqindjes në të ardhurat personale në bazë të licencimit – kualifikimit, e as nuk iu ka përgjigjur në kërkesë paditëses. Ka shtuar se në bazë të përqindjes prej 35 % të pagës bazë, për shkak të kualifikimit master, e njëjta do duhej të paguhej në shumën prej 147.00 €, mirëpo është paguar pjesërisht vetëm në shumën prej 82.55 €, për çka i ka mbetur borxh në shumën prej 64.80 €. Sa i përket inflacionit ka theksuar se nuk është kompensuar asnjëherë sipas shkallës së saj bazuar në të dhënat nga enti i statistikave të Kosovës. Për ditët e pranisë në punë për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, nuk është kompensuar për shpenzimet e ushqimit. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadiinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën që t'ia kompensojë licencimin për periudhën 01.01.2019 – 31.01.2023, duke llogaritur nga 64.8 € në muaj, për 45 muaj, në shumën e përgjithshme prej 3,175.20 €; t'ia kompensojë inflacionin për periudhën 01.01.2018 – 21.11.2022, në shumën prej 910.93 €; dhe t'ia kompensojë shpenzimet e ushqimit për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, në shumën prej 232.00 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar, edhe atë: 104.00 €, për përpilim të padisë; 42.00 €, për taksë gjyqësore; 104.00 €, për parashtresën për ndryshim të kërkesëpadiisë; dhe 104.00 €, për precizim të kërkesëpadiisë sipas aktvendimit për plotësim të datës 23.01.2024.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, inflacionit dhe shpenzimeve të ushqimit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi

nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 dhe 399.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, nr.prot.2100 e dt.01.09.2016) dhe për periudhën kohore 22.01.2021 – 21.11.2022 ka gjithsej 116 ditë të punës (vërtetimi i dt.21.11.2023 i lëshuar nga SHMT “Mehmet Isai” në Gjiilan).

Nuk është kontestuese se paditësja është mësimdhënëse e licencuar me diplomë Master (fakt i vërtetuar edhe nga certifikata e diplomës, ref.nr.2441 e dt.30.07.2014 e lëshuar nga Universiteti i Pristinës, Fakulteti i Shkencave Matematikore-Natyrore dhe licenca e mësimdhënësit nr.100000577 e dt.11.09.2012); dhe paga bazë e saj është 459.00 €, ndërsa për kualifikim paguhet në shumën prej 82.55 € (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Nuk është kontestuese se përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për për vitin 2020 është 0.2%, për vitin 2021 është 3.4 %, ndërsa për vitin 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga të dhënat e lëshuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi themelësia e kërkesëpadiisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e kërkesëpadiisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe në Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 31.01.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; nenin 35, paragrafi 7 se “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim; dhe nenin 35, paragrafi 10 se: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Master, pasi është paguar në shumën prej 82.55 € për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 160.65 €, me ç’rast i ka mbetur borxh në shumën prej 78.1 €.

Pavarësisht se diferenca e shumës së papaguar të paditëses është më e lartë sesa shuma e kërkuar me kërkespadi, gjykata ka vlerësuar se çdo vendosje ndryshe do të përbënte tejkalim të kërkesëpadi, prandaj i njohi borxhin në shumën e kërkuar prej 64.80 € për muaj.

Nga kjo arsye, gjykata detyroi të paditurën t’ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të kualifikimit shkollor – përkatësisht diferencën e papaguar për muajt e punës sa i përket periudhës 18.11.2019 – 31.01.2023.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka paguar as shkallën e inflacionit paditëses sipas të dhënave nga enti statistikor i Kosovës, e as nuk ia ka kompensuar shpenzimet e ushqimit, përkundër se ka qenë detyrim i së njëjtës. Sa i përket lartësisë së këtyre kompensimeve, shkalla e inflacionit është prej 0.2 % për vitin 2020, 3.4 % për vitin 2021 dhe 11.6 % për vitin 2022 (neni 35.10 i KKAK); dhe shpenzimet e ushqimit llogariten nga 2 € në ditë për ditët e pranisë në punë për të punësuarin, këtu paditësen (neni 35.7 i KKAK).

Nga kjo arsye, gjykata detyroi të paditurën t'ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të inflacionit për periudhën kohore 24.11.2020 – 21.11.2022 dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit sa i përket periudhës 22.01.2021 – 21.11.2022.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Meqë e paditura është thirrë në parashkrim, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi kërkesa e paditëses është kërkesë monetare që parashkruhet brenda afatit prej 3 vite, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në rastin konkret, padia sa i përket kërkesës për kualifikim/licencë është parashtruar më datë 18.11.2022, prandaj edhe kërkesa e paditëses për 3 vite llogaritet nga data 18.11.2019, ndërsa pjesa e kërkuar deri në këtë datë parashkruhet, konkretisht 01.01.2019 – 18.11.2019.

Edhe sa i përket inflacionit, gjykata ka gjetur se kërkesa e paditëses është pjesërisht e parashkruar, pasi në këtë gjykatë është iniciuar për herë të parë me parashtrësën për ndryshim të kërkesëpadsisë të datës 24.11.2023, ashtu që llogaritur për 3 vite mbrapa nga data e parashtrimit të kërkesës, e njëjta nuk është e parashkruar deri më datë 24.11.2020, ndërsa deri në këtë datë është e parashkruar. Prandaj periudhën 01.01.2018 – 24.11.2020, gjykata e refuzoi të pabazuar.

Kërkesa sa i përket shpenzimeve të ushqimit nuk është e parashkruar, pasi është iniciuar më datë 24.11.2023, ndërsa është kërkuar brenda 3 viteve, nga data 22.01.2021.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim. Edhe sa i përket pretendimit të të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohet vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve – të punësuarve si në nenin 3.2 të KKAK-së, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës. Gjykata nuk ia njohi shpenzimet sa i përket parashtrësës për ndryshim të padsisë dhe për precizim të kërkesëpadsisë, si shpenzimeve të panevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, meqë kërkesa e paditëses ka mund të jetë e saktësuar që në momentin e inicimit të padsisë në këtë gjykatë.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:244919
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05484694

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1210/22, datë 15.03.2024

Gjyqtari,
Venhar Salihu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.